

Data 15.10.2024

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Objekti: “Karburant” e ndare ne lote”: Loti 1 "Karburant per mjetet" dhe Loti 2 “Blerje karburant per ngrohje per institucionet arsimore”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Karburante 09100000-0*

*Karburant diesel 09134100-8*

**VLERA E FONDIT LIMIT:** me fond limit total **27,032,576.3** (njezet e shtate milion e tridhjete e dy mijë e peseqind e shtatedhjete e gjashte presje tre) **leke pa TVSH**, e ndare ne lote: **Loti 1 "Karburant per mjetet" me fond limit 11,371,274.43** (njemedhjete milion e treqind e shtatedhjete e nje mijë e dyqind e shtatedhjete e kater presje dyzet e tre) **leke pa TVSH; Loti 2 “Blerje karburant per ngrohje per institucionet arsimore” me fond limit: 15,661,301.87** (pesembedhjete milion e gjashteqind e gjashtedhjete e nje mijë e treqind e nje presje tetedhjete e shtate) **leke pa TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publikeka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

#### **Loti 1 "Karburant per mjetet"**

#### **2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkosat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

##### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas shtojces 9.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, nen 43, pika 2, gërmë c) pasi fondi limit i procedurës së prokurimit ndodhet nën kufirin e ulët monetar.

---

**Shënim:** Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuarara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjispcionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

**2.2.2.**Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktiveve të nenit 41, pika "c", te ligjt nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistikë te miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohen në nenin 77 të LPP, nenit 43 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar: Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japid informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përbushur nëse në bilancin/et e kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

*Përcaktimi i viteve të kërkuarara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjispcionit të fushës, konkretisht, ligjt nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të*

*ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat tatile: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatushme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatile brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet te paraqese një deklarate me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2024 sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006 ”Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kesaj deklarate duhet ti bashkengjiten te gjithe vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe.

**Shënim:** Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 ”Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi përfurnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatile të shitjes, të

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatile të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatile, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngashme argumentohet si më poshtë:

- c) *Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërbën AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngashme me objektin që prokurohet, në vlerëjo më të vogël se 20 % të fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron., në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngashme konsiderohet si kriteri thelbësor dhe si rrjetohim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si refernca/fatura tatile, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*
- d) Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngashme brenda këtij marzhi.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Lejën e Tregëtimit të Karburanteve në përputhje me Ligjin Nr.8450, date 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, te ndryshuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërmë ”a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Per përpunimin, transportimin dhe tregimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhëni e licencave për tregimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale përfurnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, pasi kjo është një procedurë shumë specifike, vetëm për blerje karburanti, lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil), e cila kërkon leje të veçantë për tregimin me paklicë të këtij malli.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë flete/raport analizat e furnizimit të fundit para zhdoganimit ose raport-analiza të lëshuara nga autoritetet përkatëse (jo më parë se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave), të bëra nga laboratori i ISHTI-it për Artikullin **Gazoil (10 ppm ULSD)** në përputhje me standartet shqiptare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërmë ”c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, të gazit dhe nenprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përbushin standartet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e këruara.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të disponoje te pakten 1 (nje) pike shitje karburanti (me shërbim, çdo ditë të javës), të vendosur ne qytetin e Pogradecit, si dhe te deklarojë emërtimin e pikes, vendndodhjen dhe adresen e sakte të saj, të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (në pronësi ose kontratë notieriale qiraje ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB).

Në deklaratë të cilësohet gjithashtu që furnizimi do kryhet nepermjet kartave elektronike te cilat do menaxhohen nepermjet sistemit te integruar web. Operatori duhet te deklaroje se bazuar ne VKM Nr. 561 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se per gjithshem” i ndryshuar, do furnizoje autoritetitit kontraktor me karta elektronike per cdo mjet qe do kerkonte autoriteti te cilat do jene te gjurmueshme me targat e mjetit dhe te menaxhueshme nga administratori i sistemit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërmë ”ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 561, datë 29.07.2016, “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit ne njesite e qeverisjes se per gjithshem“.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburante, detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë në lëng të gjithe sasine e litrave të ndodhura në magazinen elektronike dhe kartën elektronike të personalizuar te automjetit, te cilat do jene pa skadencë deri në përfundimin e plotë të furnizimit te kontraktuar, sipas nevojave të autoritetit kontraktor.

- Bazuar në VKM Nr.561 datë 29.07.2016, “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshem“ Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit përmjet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkua më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërmë ”ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 561, datë 29.07.2016, “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit ne njesite e qeverisjes se përgjithshem“.

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të vetdekalarimit se ofron një webpage përmjet menaxhimit e karburanteve, në mënyrë që të të ofrojë shërbimin e ngarkimit/transferimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit kontraktor me karte elektronike.*

**Të gjitha dokumentet duhet të janë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **Loti 2 “Blerje karburant per ngrohje per institucionet arsimore”.**

### **2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

**Argumentimi:** Kërkosat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas shtojces 9.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, nen 43, pika 2, gërmë c) pasi fondi limit i procedurës së prokurimit ndodhet nën kufirin e ulët monetar.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuar për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

**2.2.2.**Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktive të nenit 41, pika "c", te ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistikë te miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohen në nenin 77 të LPP, nenit 43 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshaur: Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kérkojë që operatorët ekonomikë të japid informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kérkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përbushur nëse në bilancin/et e kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

*Përcaktimi i viteve të kërkuar për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkësave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të*

*ardhurat tatimore: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatushme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet te paraqese një deklarate me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2024 sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006 "Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kesaj deklarate duhet ti bashkengjiten te gjithe vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe.

**Shënim:** Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar), ku në zbatim të legjisacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vëndet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

## **2.4 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi përfundimt e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkjesave të legjisacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

- a) *Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërbën AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerëjo më të vogël se 20 % të fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron., në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjetohim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tillë si referanca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*
- b) Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

**2.3.2** Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in licensat përkatëse **për tregtimin me pakicë të karburanteve**, gazit të leng-shëm të naftës,vajrave lubrifikant edhe lëndëve djegëse **përdorim nga konsumatorët fundorë**. (*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotesohet nga secili anetar i bashkimit,në përpunim me përqindjen e pjesëmarrjes të furnizimeve, të përcaktuara në akt marrëveshje*).

**Argumentimi:** “Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërmë a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Ligjin Nr.8450, dat 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” të ndryshuar me Ligjin Nr.9218, datë 08.04.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8450, Datë 24.2.1999 “Per përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe në V.K.M Nr. 129, datë 18.03.1999 “Për procedurat dhe kushtet për dhënen e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e nënprodukteve të tyre” të ndryshuar me V.K.M Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime për procedurat dhe kushtet për dhënen e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre.

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.*

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë/raport analizat e furnizimit të fundit para zhdoganimit ose raport-analiza të lëshuara nga autoritetet përkatëse (jo më parë se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave), të bëra nga laboratori i ISHTI-it për Artikullin **Gazoil (10 ppm ULSD) dhe Gaz i lengeshem GLN** në përputhje me standartet shqiptare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërmë ”c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, të gazit dhe nenprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përbushin standartet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokuohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkua.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet te paraqese një Deklarate ne baze te se ciles merr persiper furnizimin me gaz dhe gazoil 10 ppm me autobotet e tij dhe me shpenzimet e tij deri ne vendin ku ndodhen depozitat e autoritetit kontraktor duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore për transportin e lëndeve djegëse, sipas standardeve ne fuqi.

**Argumentimi:** : Kërkesa e mesipërme është vendosur bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 pika 8, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar.

*Kriteri i mesiperm u vendos me qellim te garantohet furnizimi me gazoil dhe me gaz sipas kushteve te autoritetit kontraktor.*

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka në pronësi ose me qera 2 (dy) mjete transporti:

- 1 (nje) Autobot per transportin e **Gaz i lengeshem GLN**.
- 1 (nje) Autobot per transportin e **Gazoil (10 ppm ULSD)**

**Shenim:** Mjetet te jene te pajisura me aparatin matës.

*“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

**Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori/et ekonomik duhet të paraqese:**

- Për mjetet me rrata që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet :
- a) për mjetet në pronësi te vertetuar me :
    - leje qarkullimi
    - certifikatë pronësie
    - certifikatë e kontrollit teknik të mjetit( të vlefshme )

- polisen e sigurimit te mjeteve (të vlefshme)
- Çertifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit (te vlefshme).
- foto të mjetit

b) për mjetet e siguruara me qera

- kontrate qiraje (të vlefshme)
- leje qarkullimi
- certifikatë e kontrollit teknik të mjetit( të vlefshme )
- polisen e sigurimit te mjeteve (të vlefshme)
- Çertifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit (te vlefshme).
- foto të mjetit

*Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certifikate e transportit te mallrave ) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdonim vetjak por per perdonim nga te tretet.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar.

Kriteri i mesiperm u vendos duke qene se lenda djegese do te shperndahet ne disa prej institucioneve arsimore te Bashkise Pogradec.

*Per sa me siper eshte e nevojshme vendosja e kriterit per disponimin e dy autoboteve, qe duhet te jene te pajisuar me dokumentacionin e nevojshem per qarkullim ne menyre qe te realizohet me sukses furnizimi i kaldajave me gaz dhe gazoil 10 ppm.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme osetë pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike (Për të 2 lotet)**

**Argumentim:** Hartimi i specifikime teknike të Gazoilit (Diesel 10 ppm ULSD) dhe gaz i lengshem GNL është bërë në përputhje me Standarde Shtetërore në fuqi të publikuara aktualisht në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve, Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi*

*ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tillë duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

#### **NJËSIA E PROKURIMIT**